



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 247
Datë 21.02.2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2019, mori:

VENDIM

- I. Për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore (bachelor) dhe studimet posdiplomike (master), për vitin akademik 2018-2019.
- II. Kandidatët, të cilët do të konkurrojnë për përfitim të bursës universitare, duhet të plotësojnë këto kushte:
 1. të jenë student të rregullt të Universitetit të Mitrovicës,
 2. të jenë student të vitit të dytë e më lart,
 3. të mos kenë vit të përsëritur të studimeve,
 4. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit,
 5. të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:
 - 8.0 (tetë pikë zero) – për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; dhe
 - 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e Fakultetit Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.
 - 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e nivelit master.
- III. *Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2018/2019 është 1000 euro.*
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Menaxhmentit të UMIB-it,
3. Dekanëve të njësive akademike
4. Shërbimit financiar
5. Zyrtarit ligjor



Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues